



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 41	2001	Korrik
--------	------	--------

P Ë R M B A J T J A

Vendim i KM nr.310, datë 12.5.2001	Për kalimin e shërbimit të buxhetit bankave tregtare, me seli në Republikën e Shqipërisë	1279
Vendim i KM nr.413, datë 11.6.2001	Për një ndryshim në vendimin nr.354, datë 29.8.1994 të Këshillit të Ministrave “Për shpërblimin e cilësisë së veprimtarive sportive për sportistët, trajnerët e gjyqtarët dhe shpërblime të tjera sportive”	1280
Vendim i KM nr.416, datë 11.6.2001	Për dhënie fondi Partisë Demokratike Shqiptare	1281
Vendim i KM nr. 463, datë 12.7.2001	Për disa ndryshime në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagave të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, ndryshuar me vendimet nr.377, datë 14.7.2000 dhe nr.426, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave	1281

Vendim i GJK nr.70, datë 6.7.2001	Me objekt shfuqizimin e pjesshëm të vendimit nr.007, datë 30.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	1284
Vendim i GJK nr.72, datë 13.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.977, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.42.....	1285
Vendim i GJK nr.73, datë 17.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.129, datë 9.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.28.....	1287
Vendim i GJK nr.74, datë 17.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.997, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	1288
Vendim i GJK nr.75, datë 18.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.984, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	1290
Vendim i GJK nr.76, datë 18.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.166, datë 12.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	1292
Vendim i GJK nr.77, datë 18.7.2001	Me objekt shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit nr.968 të datës 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.17 Mat.....	1294
	<i>Kërkesë për shpallje të vdekur të shtetasit Përparim Pashako....</i>	1295

V E N D I M
Nr.310, datë 12.5.2001

**PËR KALIMIN E SHËRBIMIT TË BUXHETIT BANKAVE TREGTARE, ME SELI NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.8563, datë 22.12.1999 “Për përcaktimin e formës dhe formulës së privatizimit të Bankës së Kursimeve” sh.a., me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Lejimin e Ministrisë së Financave të prokurojë me procedurën e prokurimit “Tender i hapur”, me afat të përshpejtuar jo më pak se 10 ditë, kryerjen e shërbimit të buxhetit me bankat tregtare, me seli në Republikën e Shqipërisë.

2. Komisionet e kryerjes së këtij shërbimi nga bankat e nivelit të dytë nuk duhet të jenë më të larta se sa ato të parashikuara në Aneksin nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Në ato qytete ku veprimtaritë bankare kryhen nga Banka e Kursimeve, sh.a., të vazhdojnë të kryhen nga kjo bankë, për atë kohë sa kjo veprimtari nuk do t’i afrohet ndonjë shoqërie tjetër, të licencuar për të kryer veprimtari bankare.

4. Termat e referencës për prokurimin e këtij shërbimi përgatiten dhe shpallen nga Ministria e Financave, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

ANEKSI NR. 1
KOMISIONE BANKARE PËR SHËRBIMET E BUXHETIT në lekë

1	Derdhje cash nga institucionet buxhetore	1% 00 min 150 max 1500
2	Transferta	
2.1	Brenda degës së bankës	1% 00 min 150 max 1500
2.2	Jashtë degës së bankës	2% 00 min 700 max 3000
3	Emetimi dhe përpunimi i çeqeve	
3.1	Emetimi i Çekut bankar	1% 00 min 500 max 1000
3.2	Pranimi i çeqeve për arkëtim	
3.2.1	Të pagueshëm menjëherë	1% 00 min 200 max 1000
3.2.2	Pas arkëtimit	1% 00 min 150 max 1500
3.2.3	Pagesa e çeqeve në arkë	1% 00 min 150 max 1500
3.3	Pajisje me modular	
3.3.1	Blllok me 10 fletë	1000
3.3.2	Një fletë	150
4	Letër krediti	

4.1	Komision njoftimi	1.5% 00 min 7000
4.2	Komision konfirmimi	2% 00 min 7000
4.3	Komision pagese	1.5% 00 min 7000
4.4	Komision modifikimi	7000
4.5	Pagesë e vonuar	2% 00
4.6	Komision anulimi	6000
5	Garancitë	
5.1	Emetimi	0.5 % 00 min 5000 max 30000
5.2	Modifikimi	6000
5.3	Pagesa	1% 00 min 7000 max 50 000
5.4	Mospërdorimi	5000
6	Nxjerrja e llogarisë dhe njoftimi i klientit	
6.1	Periodike	Pa komision
6.2	Me kërkesë të klientit	500
6.3	Mbajtja e llogarive dhe veprimet e mbylljes	pa komision

V E N D I M
Nr.413, datë 11.6.2001

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.354, DATË 29.8.1994 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPËRBLIMIN E CILËSISË TË VEPRIMTARIVE SPORTIVE PËR
SPORTISTËT, TRAJNERËT E GJYQTARËT DHE SHPËRBLIME TË TJERA SPORTIVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3 të ligjit nr.8114, datë 28.3.1996 “Për sportin”, ndryshuar me ligjin nr.8650, datë 28.7.2000 dhe të nenit 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Paragrafët i parë, i dytë dhe i tretë, në lidhjen nr.5 të vendimit nr.354, datë 29.8.1994 të Këshillit të Ministrave ndryshohen si më poshtë vijon:

“- Për gjyqtarët dhe vëzhguesit e futbollit dhe të basketbollit jo më pak se 2000 lekë.

- Për gjyqtarët dhe vëzhguesit e sporteve të tjera jo më pak se 1500 lekë”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe nga të ardhura të tjera.

3. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe federatat sportive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.416, datë 11.6.2001

PËR DHËNIE FONDI PARTISË DEMOKRACIA PAQËSORE SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” dhe të nenit 7 të ligjit nr.8718, datë 19.12.2000 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Partisë Demokracia Paqësore Shqiptare t’i jepet një fond prej 100 000 (një qind mijë) lekësh, si ndihmë financiare në çastin e krijimit të saj.
 2. Ky fond të përballohet nga fondet buxhetore të vitit 2001 për partitë e reja.
 3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M **Nr. 463, datë 12.7.2001**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.194, DATË 22.4.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGAVE TË PUNONJËSVE MËSIMORË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”, NDRYSHUAR ME VENDIMET NR.377, DATË 14.7.2000 DHE NR.426, DATË 11.6.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagave të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, ndryshuar me vendimet nr.377, datë 14.7.2000 dhe nr.426, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave, lidhja nr.1 “Struktura e pagës për punonjësit mësimorë”, lidhja nr.2, lidhja nr.3 “Shpërblimi mujor për punonjësit mësimorë në arsimin parauniversitar, që punojnë larg vendbanimit” zëvendësohen me lidhjet me të njëjtin numër, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2001, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.7.2001.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

STRUKTURA E PAGËS PËR PUNONJËSIT MËSIMORË **LIDHJA NR.1**

Emërtimi	Paga mujore				
	Paga individuale			Shtesa e profesionit	
	Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHK)	Shtesa për kualifikim (SHP)	Shtesa për pozicion (SHP)	Totali

Drejtor i shkollës së mesme Përgjegjës poli-goni Dr.Inst. të nxën. që nuk shikojnë Drej.Inst.të nxën. që nuk dëgjojnë Dr.në shkolla me PLM Drejtor konvikte-ve	1	2% PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	11095 lekë	Nga...lekë Deri... lekë
Zv/Dr.në shkollë të mesme Dr. i shkollës 8-vjeçare Zv/Dr. në inst.e nx. që nuk shikojnë e dëgjojnë dhe shkollat me PLM. Dr. i Qendrës. Kult. të Fëmijëve Përgjegjës i bazës prodhuese	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	9741 lekë	Nga ...lekë Deri...lekë
Dr. i shkollës fillore (klasa e I-IV) Përgj.(kryemësues i shk. me klasë kolektive Zv/Dr.i shk.8- vjeçare Përgj. sekt. në Qend. Kult. Fëm.	1	“	“	8464 lekë	Nga ...lekë Deri...lekë
Dr.i Kopshtit me ushqim	1	“	“	7398 lekë	“
Dr.i kopshtit pa ushqim	1	“	“	6158 lekë	“
Mësuese në shkollat e mesme					
Mësues në shk. së ulët profesionale Mësues në Inst. e nx. që nuk shikojnë e nuk dëgjojnë dhe Shk.me PLM	1	“	“	7791 lekë	Nga...lekë Deri...lekë
Mësues në Shk.8-vjeçare (I-VIII) Edukatore konvi-kti Kujdestar konvi-kti. Instruktur në Qendrën Kultu-rove të Fëmijëve	1	“	“	6795 lekë	Nga...lekë Deri...lekë
Edukatore në Kop. fëmijësh	1	“	“	5607 lekë	“
Mësues në shk. të mes. dhe 8- vjeçare	3	“	“	6795 lekë	Nga ... lekë Deri ... lekë
Edukator në kop.fëmijësh	3	“	“	5607 lekë	“

LIDHJA NR.2

Grupi	Paga në lekë
1.	7128 lekë
2.	5940 lekë
3.	5346 lekë
4.	3564 lekë

Shpërblimi mujor për punonjësit mësimorë
në arsimin parauniversitar që punojnë larg vendbanimit

LIDHJA NR.3

MËSUESIT QË PUNOJNË LARG VENDBANIMIT TË TYRE MARRIN SHPËRBLIM, SI VIJON:

- Kur punojnë brenda rrethit të tyre, por larg vendbanimit dhe kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre - deri në 1152 lekë, kur nuk kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre - deri në 3456 lekë.

- Kur punojnë jashtë rrethit të tyre në rrethet Pukë, Tropojë, Kukës, Has, Malësi e Madhe, Dibër, Bulqizë - deri në 4611 lekë kur punojnë në qytete dhe në qendër të rrethit, dhe deri në 5756 lekë kur punojnë jashtë qytetit dhe qendrës së rrethit.

- Kur punojnë jashtë rrethit të tyre të vendbanimit në rrethet Mat, Mirditë, Gramsh, Librazhd - deri në 3456 lekë kur punojnë në qytet dhe në qendër, dhe deri 4611 lekë kur punojnë jashtë qytetit dhe qendrës së rrethit.

- Kur punojnë jashtë rrethit të tyre të vendbanimit në rrethet e tjera - deri në 2300 lekë kur punojnë në qytete dhe në qendrën e rrethit, dhe deri 3456 lekë kur punojnë jashtë qytetit e qendrës së rrethit.

V E N D I M
Nr.70, datë 6.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	“““
Gjergj Sauli,	Anëtar i	“““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	“““
Kujtim Puto,	Anëtar i	“““
Tefta Zaka,	Anëtare e	“““
Petrit Plloçi,	Anëtar i	“““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	“““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	“““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 5.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapra çështjen nr.81 Akti që i përket:

KËRKUES:LEKË ÇUKAJ, me kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.2, përfaqësuar me deklarin nga avokat Gjin Progni.

SUBJEKTE TË INTERESUAR:

1. **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
2. **MARK KROQI**, kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.2, përfaqësuar me prokurë nga vokat Adnor Shameti.
3. **KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.2**, përfaqësuar nga kryetari Ndue Dodaj.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i pjesshëm i vendimit nr.007, datë 30.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoj relatorin e çështjes Kristofor Peçi, kërkesin dhe përfaqësuesin e tij, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.007, datë 30.6.2001, ka vendosur të mos shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën nr.2 dhe t'i shpallë të pavlefshme zgjedhjet në 18 qendra votimi.

Kërkesi ka pretenduar se vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për një pjesë të qendrave të votimit nuk është i drejtë, sepse në to zgjedhjet janë zhvilluar normalisht dhe është nxjerrë rezultati nga komisioni i zonës.

Gjykata Kushtetuese çmon se kërkesa e tij është e drejtë dhe duhet pranuar. Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.2, me vendimin nr.9, datë 26.6.2001, ka vendosur që të ribëhen zgjedhjet në 5 qendrat e votimit. Ky vendim është nënshkruar rregullisht nga i gjithë komisioni. Ndërsa me vendimin nr.10 të po kësaj date, Komisioni i Zonës ka njohur rezultatin në të gjitha qendrat e tjera të votimit. Për më tepër, procesverbalet e qendrave të votimit janë nënshkruar nga shumica e anëtarëve dhe në to nuk ka asnjë vërejtje për parregullsi.

Në këto kushte, vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për pjesën që ka shtuar edhe qendra të tjera votimi për t'u përsëritur zgjedhjet, pa u konsultuar sipas ligjit me komisionin e zonës zgjedhore përkatëse, është i padrejtë dhe duhet shfuqizuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës, nenit 141 të Kodit Zgjedhor, si dhe neneve 66, 67 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Pranimin e pjesshëm të kërkesës për shfuqizimin e vendimit nr.007, datë 30.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për pjesën që ka shpallur të pavlefshme rezultatet e zgjedhjeve në pesë qendra votimi të zonës nr.2 Shkodër dhe konkretisht në qendrat e votimit nr.11 dhe 13 të Komunës Shkrel, 1 dhe 6 të Komunës Pult dhe 8 të Komunës Temal.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M Nr.72, datë 13.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	“““
Alfred Karamuco,	Anëtar i	“““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	“““
Kujtim Puto,	Anëtar i	“““
Petrit Plloçi,	Anëtar i	“““
Tefta Zaka,	Anëtare e	“““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	“““
Gjergj Sauli,	Anëtar i	“““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 13.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.96 Akti që i përket:

KËRKUES:BUJAR LAKO, kandidat për deputet i koalicionit “Bashkimi për Fitore”.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
2. ERMELINDA MEKSI, përfaqësuar me prokurë nga Bujar Xhafa.
3. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.42, përfaqësuar nga zëvendëskryetare Mamica Shehu.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.977, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.42

BAZA LIGJORE:Nenet 107/b,c, 141 të Kodit Zgjedhor dhe 68/2 të Kushtetutës

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gjergj Sauli, kërkuesin, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me kërkesën paraqitur Gjykatës Kushtetuese, kërkuesi Bujar Lako pretendon se vendimi nr.977, datë 29.6.2001 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me të cilin është lënë në fuqi vendimi nr.58, datë 25.6.2001 i Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.42, është i pavlefshëm, sepse janë shkelur haptazi dispozitat e Kodit Zgjedhor.

Gjatë gjykimit të çështjes, nga administrimi i provave rezultoi se kërkuesi nuk ka bërë ankim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kundër vendimit nr.58, datë 25.6.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.42, me të cilin është shpallur deputete zonja Ermelinda Mexi. Ky fakt tregon se kërkuesi është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese pa konsumuar mjetet e tjera ligjore të ankimit në rrugë administrative, prandaj në bazë të nenit 131 shkronja “f” të Kushtetutës dhe neneve 107 e 140 të Kodit Zgjedhor nuk legjitimohet të bëjë ankim në Gjykatën Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronjat “e, f” të Kushtetutës, neneve 140 e 141 të Kodit Zgjedhor, si dhe të neneve 26, 67 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M

Nr.73, datë 17.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPERISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““

Petrit Plloçi,	Anëtar i	“““
Tefta Zaka,	Anëtare e	“““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	“““
Gjergj Sauli,	Anëtar i	“““

me sekretare Arbenka Lalice, në datën 17.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.99 Akti që i përket:

KËRKUES: HAJDAR KOVAÇI, kandidat për deputet i koalicionit “Bashkimi për Fitore”, përfaqësuar me deklaram nga avokatët Ilir Panda e Mirash Martini.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
2. GJERGJ KOJA, përfaqësuar me deklaram nga avokat Nikolla Kondakçi.
3. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.28, përfaqësuar nga kryetari Shpëtim Beqiraj.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.129, datë 9.7.2001 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.28

BAZA LIGJORE:Nenet 3, 113, 141/I të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Gjergj Sauli, kërkesin dhe përfaqësuesit e tij, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me kërkesën paraqitur Gjykatës Kushtetuese, kërkesi Hajdar Kovaçi pretendon se vendimi nr.129, datë 9.7.2001 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me të cilin është lënë në fuqi vendimi nr.17, datë 8.7.2001 i Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.28, është i pavlefshëm, sepse është ushtruar dhunë e janë shkelur haptazi dispozitat e Kodit Zgjedhor.

Gjatë gjykimit të çështjes, nga administrimi i provave, rezultoi se kërkesi nuk ka bërë ankim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kundër vendimit nr.17, datë 8.7.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.28, me të cilin është shpallur deputet zoti Gjergj Koja. Ky fakt tregon se kërkesi është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese pa konsumuar mjetet e tjera ligjore të ankimit në rrugë administrative, prandaj në bazë të nenit 131 shkronja “f” të Kushtetutës dhe neneve 107 e 140 të Kodit Zgjedhor nuk legjitimohet të bëjë ankim në Gjykatën Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronjat “e, f” të Kushtetutës, neneve 140 e 141 të Kodit Zgjedhor, si dhe të neneve 26, 67 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.74, datë 17.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Gjergj Sauli,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Petrit Plloçi,	Anëtar i “““
Tefta Zaka,	Anëtare e “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““

me sekretare Drita Panda, në datën 9.7.2001 dhe 14.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.82 Akti që i përket:

KËRKUESE:PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË, përfaqësuar me prokurë nga avokatët Fatmir Gjika e Kujtim Bara.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
2. SALI SHEHU, përfaqësuar me prokurë nga avokat Artan Zeneli.
3. SHEFQET HOTI, zëvendëskryetar i Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.21.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.997, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke parashtruar këto shkaqe:

- Gjatë zhvillimit të procesit zgjedhor të raundit të parë, në zonën zgjedhore nr.21 Dibër janë vërejtur shkelje ligji që e bëjnë rezultatin e pavlefshëm.
- Votimet në disa qendra votimi kanë filluar pas orës 15.00.
- Kutitë e votimit të qendrave të votimit të Komunës Kala e Dodës janë manipuluar nga kryetari i komunës.
- Në të gjitha fshatrat e Komunës Kala e Dodës, në Vakuf, Kastriot, Lurë, etj., një person ka votuar për familjen në disa raste edhe për fisin.
- Rreth 80% e dokumenteve të votimit janë sjellë nga komisionet e qendrave të votimit të hapura.
- Në 70% të procesverbaleve të komisioneve të qendrave të votimit ka nënshkrime fiktive.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, përfaqësuesit e kërkesit, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbi ankimin e kandidatit për deputet Petrit Bara të subjektit elektorale të Partisë Socialiste, me vendimin nr.997, datë 29.6.2001, ka lënë në fuqi vendimin nr.21, datë 26.6.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.21 Dibër, duke shpallur si fitues kandidatin e pavarur për deputet zotin Sali Shehu.

Në shqyrtimin gjyqësor të çështjes nga Gjykata Kushtetuese, përfaqësuesit e kërkesit, pasi parashtruan përgjithësisht shkaqet e ngritura në kërkesë, pretenduan që provat e dokumentet shkresore që mbështesin pretendimet e tyre ndodhen pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ku ishin dorëzuar me rastin e ankimit. Gjykata tërhoqi dokumentacionin sipas kërkesës dhe vlerësoi provat në tërësi e veçanërisht shënimet e bëra në tabelën e rezultateve nga Komisioni i Zonës Zgjedhore, protokollet e

Komisionit të Zonës Zgjedhore të datave 24 e 26.6.2001 e dokumente të tjera shkresore.

Për të arritur një konkluzion më të plotë e më të bazuar, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kutitë e votimit për pesë qendra votimi e konkretisht për ato me nr.4 e 5 të Komunës Kala e Dodës, nr.4 të Komunës Fushë-Çidhën dhe nr.12/1 e 15 të Komunës Kastriot. Gjykatës iu vunë në dispozicion vetëm kutitë e 3 qendrave të votimit e konkretisht nr.4 Kala e Dodës dhe 12/1 e 15 Kastriot.

Nga tërësia e provave të administruara, Gjykata Kushtetuese ka arritur në përfundimin se procesi zgjedhor në 17 qendra votimi të zonës zgjedhore nr.21 është kryer me shkelje ligjore, të cilat kanë ndikuar në nxjerrjen e rezultatit.

Në mënyrë të grupuar shkeljet paraqiten:

Në procesin e votimit:

- Në qendrën e votimit nr.7 të Komunës Kala e Dodës, votimet nuk kishin filluar për më se gjashtë orë rresht, shkak ky për pavlefshmëri në kuptim të pikës 1 shkronja “b” të nenit 113 të Kodit Zgjedhor.

- Në qendrën e votimit nr.4 Kala e Dodës, ka me shumicë raste ku një person ka nënshkruar në listën e votimit në emër të mjaft personave të tjerë. Për më tepër, në kutinë e kësaj qendre votimi u gjetën me shumicë fletëvotimi të plotësuar, por të ngjitura në formë blloku.

- Në qendrën e votimit nr.15 Kastriot, regjistri i qendrës së votimit s’ka asnjë nënshkrim të zgjedhësve e për pasojë nuk dokumentohet nëse është kryer votimi.

Në procesin e nxjerrjes së rezultatit:

Nga një numër qendrash votimi, dokumentacioni i votimit si fletët e votimit e procesverbalet, shpesh edhe vulat janë çuar në komisionin e zonës zgjedhore të hapura e jashtë kutisë përkatëse. Këto veprime, të cilat kanë lënë shteg për manipulim të rezultateve, bien ndesh me rregullat e përcaktuara nga neni 106 i Kodit Zgjedhor. Shkelje të kësaj natyre, sipas dokumenteve të administruara, janë konstatuar në qendrat e votimit nr. 3, 4, 5, 10, 11, 14, 15 të Komunës Kastriot; nr.4, 5, 6, 7 të Kalasë së Dodës; nr.1, 4 Tomin; nr.3 Arras; nr.4 Fushë-Çidhën; nr.5 Komuna Sllovë; nr.1 Komuna Lurë.

Përsa i përket pretendimeve të kërkuësit se 70% e procesverbaleve të komisioneve të qendrave të votimit kanë nënshkrime fiktive, me provat e administruara nga Gjykata, nuk u vërtetua.

Nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin se në qendrat e votimit të zonës nr.21 Dibër (të përmendura në vendim) janë vërtetuar shkelje të cilat në bazë të nenit 113 të Kodit Zgjedhor i bëjnë zgjedhjet në këto njësi zgjedhore të pavlefshme, duke shtruar njëkohësisht nevojën e përsëritjes së tyre.

Meqënëse objekti i kërkesës dhe i shqyrtimit gjyqësor ka qenë vendimi nr.997, datë 29.6.2001 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që shpall fitoren si deputet të zotit Sali Shehu, në mbështetje të nenit 48 paragrafi i parë i ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, kjo e fundit nuk mund të shprehet lidhur me vlefshmërinë e listës shumëmemërore.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “e” të Kushtetutës, si dhe nenit 113 të Kodit Zgjedhor, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.997, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke shpallur të pavlefshme zgjedhjet në 17 qendra votimi të zonës zgjedhore nr.21 Dibër dhe konkretisht:

- në Komunën Kastriot në qendrat e votimit nr.3, 4, 5, 10, 11, 14 dhe 15;
- në Komunën Kala e Dodës në qendrat e votimit nr.4, 5, 6 dhe 7;
- në Komunën Tomin Qendër në qendrat e votimit nr.1 dhe 4;
- në Komunën Arras në qendrën e votimit nr.3;
- në Komunën Fushë-Çidhën në qendrën e votimit nr.4;
- në Komunën Sllovë në qendrën e votimit nr.5;
- në Komunën Lurë në qendrën e votimit nr.1.

2. Urdhëron zhvillimin e zgjedhjeve të raundit të parë vetëm për listën njëmemërore në qendrat

e votimit të lartpërmendura.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.75, datë 18.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPERISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Zija Vuci, Anëtar i “““

Gjergj Sauli, Anëtar i “““

Alfred Karamuço, Anëtar i “““

Kristofor Peçi, Anëtar i “““

Kujtim Puto, Anëtar i “““

Petrit Plloçi, Anëtar i “““

Tefta Zaka, Anëtare e “““

Sokol Sadushi, Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 5.7.2001 dhe 7.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.80 Akti që i përket:

KËRKUESE:MAKBULE ÇEÇO, kandidate për deputete e Partisë Socialiste, përfaqësuar nga avokat Arben Hakani.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.

2. ROLAND BEJKO, kandidat për deputet i koalicionit “Bashkimi për Fitore”, përfaqësuar nga juristi Vladimir Mulaj.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.984, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkujes, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.984, datë 29.6.2001, ka shpallur rezultatin e zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.89, duke mos njohur fitues asnjë kandidat për deputet, si dhe zhvillimin e raundit të dytë të zgjedhjeve në këtë zonë në datën 8 korrik ndërmjet kandidates për deputete të Partisë Socialiste zonjës Makbule Çeço dhe kandidatit të koalicionit “Bashkimi për Fitore” zotit Roland Bejko.

Kërkujesja ka pretenduar përpara kësaj Gjykate se në raundin e parë të zgjedhjeve janë evidentuar mjaft parregullsi dhe shkelje ligjore në qendrat e votimit nr. 23, 24 dhe 25 të Komunës së Lazaratit.

Shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje në Gjykatën Kushtetuese dhe verifikimi i pretendimeve të palëve në proces, që lidheshin kryesisht me hapjen e kutive të votimit, listat e zgjedhësve dhe falsitetin e tyre, ka qenë objektivist i pamundur që të përfundonte përpara datës 8 korrik 2001, datë e cila ishte caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të zhvilluar raundin e dytë të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.89.

Pas zhvillimit të raundit të dytë të zgjedhjeve, Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.89 ka shpallur

fituese kandidaten për deputete të Partisë Socialiste zonjën Makbule Çeço.

Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me një kërkesë për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes kundër vendimit nr.984, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se çështja duhet të pushohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 131 shkronja “e” të Kushtetutës, si dhe në nenet 1, 26 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I :

- Pushimin e gjykimit të çështjes.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M

Nr.76, datë 18.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	“““
Gjergj Sauli,	Anëtar i	“““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	“““
Kujtim Puto,	Anëtar i	“““
Petrit Plloçi,	Anëtar i	“““
Tefta Zaka,	Anëtare e	“““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	“““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	“““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 16.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.98 Akti që i përket:

KËRKUESE:LIRI DIBRA, përfaqësuar me deklaram nga avokat Kreshnik Spahiu.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
2. BARDHYL AGASI
3. KOMISIONI I ZONES ZGJEDHORE NR.29, përfaqësuar nga kryetari Lluka Kuqi.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.166, datë 12.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuesses, të subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Më datën 8.7.2001, në zonën zgjedhore nr.29 u zhvillua raundi i dytë i zgjedhjeve ndërmjet

kërkueses Liri Dibra si kandidate e koalicionit “Bashkimi për Fitore” dhe Bardhyl Agasi kandidat i Partisë Socialiste. Sipas procesverbalit përfundimtar rezultoi se Bardhyl Agasi ka marrë 5 371 vota, Liri Dibra 5 251 vota dhe 458 vota kanë dalë të pavlefshme.

Meqënëse një rezultat i tillë imponon zbatimin e kriterëve të rinumërimit të fletëve të votimit, të parashikuara nga neni 108 i Kodit Zgjedhor, për faktin se votat e pavlefshme ishin në numër më të madh se diferenca mes dy kandidatëve, Komisioni i Zonës Zgjedhore ka organizuar rinumërimin e votave nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Durrësit. Kjo e fundit, pas rinumërimit të votave ka nxjerrë rezultatin 5 365 vota për Bardhyl Agasin dhe 5 231 vota për Liri Dibrën, ndërsa 465 vota janë shpallur të pavlefshme. Në bazë të këtij rezultati, Komisioni i Zonës Zgjedhore, me vendimin nr.13, datë 12.7.2001, ka shpallur deputet të zonës zotën Bardhyl Agasi, ndërsa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.166, datë 12.7.2001, ka shpallur rezultatin përfundimtar duke njohur si fitues po këtë kandidat.

Kërkuesja Liri Dibra parashtron para Gjykatës Kushtetuese se kjo shpallje është në kundërshtim me rregullat e Kodit Zgjedhor, sepse fletët e pavlefshme janë në favor të saj, siç kërkohet në nenin 106/3 të Kodit Zgjedhor, pasi në fletët e votimit që janë konsideruar të pavlefshme janë vendosur dy kryqe në të dy krahët e emrit të saj. Ajo pretendon se një veprim i tillë është në kundërshtim me ligjin, me udhëzimin nr.63, datë 6.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe praktikën e Gjykatës Kushtetuese me rastin e rinumërimit të votave.

Këtë pretendim të kërkueses, Gjykata Kushtetuese nuk e çmon të bazuar. Rinumërimi i votave është bërë sipas kriterëve të caktuar në Kodin Zgjedhor. Gjykata e Shkallës së Parë ka marrë në shqyrtim dhe ka rikonsideruar edhe votat e pavlefshme, siç del edhe nga ndryshimi i numrit të tyre në raport me rezultatin e raundit të dytë të zgjedhjeve. Në këto kushte, Gjykata ka kryer një proces të rregullt ligjor dhe, për këtë shkak, vendimi i saj nuk lë shteg për t’u kundërshtuar për proces të parregullt. Përsa i përket mënyrës së vlerësimit që i ka bërë gjykata fletëve të votimit, kjo është në përputhje me kompetencat e saj të parashikuara në ligj, i cili jo vetëm që i jep të drejtë gjykatës të marrë vendim për rinumërimin e votave, por, sipas nenit 112 të Kodit Zgjedhor, këto vendime janë të formës së prerë.

Rinumërimi i votave, si një proces jo i zakonshëm që bëhet vetëm në kushte të caktuara sipas kriterëve ligjore, ka për qëllim verifikimin dhe saktësimin e fletëve të votimit në mënyrë që të arrihet në një rezultat të qartë e të pakontestueshëm, i cili shpallet menjëherë. Gjatë rinumërimit, Gjykata ka të drejtë dhe njëkohësisht detyrë që të bëjë të gjitha verifikimet e nevojshme dhe të nxjerrë rezultatin faktik. Sipas ligjit, në rast mospërputhjeje të rezultatit të shënuar në tabelën e qendrës së votimit, konsiderohet i saktë numri i fletëve të votimit të gjetura në zarf gjatë rinumërimit (neni 110/ç i Kodit Zgjedhor).

Duke pasur një qëllim të tillë, rinumërimi i është besuar me ligj një organi të paanshëm siç është Gjykata, e cila bën edhe vlerësimet përkatëse. Në këtë kuptim, shpallja e rezultatit nga Komisioni i Zonës Zgjedhore, mbi bazën e tabelës të plotësuar nga gjykata pas rinumërimit të votave, është një veprim i kushtëzuar nga ligji, sipas të cilit shpallja e rezultatit bëhet vetëm nga komisioni i zonës zgjedhore si organ kompetent e jo nga gjykata. Ky arsyeim vlen edhe për shpalljen e rezultatit përfundimtar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që bëhet po në bazë të tabelës së rinumërimit.

Është e vërtetë se në bazë të Kodit Zgjedhor, vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në lidhje me rezultatet përfundimtare dhe të zgjedhjeve dhe pavlefshmëria e tyre, ankimohen në Gjykatën Kushtetuese, por gjithashtu është i padiskutueshëm edhe përcaktimi tjetër se vendimet e gjykatës gjatë rinumërimit të votave janë të formës së prerë. Prandaj, në këto kushte, as Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk mund të vendosë në kundërshtim me vendimin e gjykatës dhe as Gjykata Kushtetuese nuk mund të shqyrtojë paligjshmërinë ose jo të këtij vendimi. Përkundrazi mund të bëhet nëse gjykata ka shkelur një të drejtë kushtetuese nëpërmjet një procesi të parregullt ligjor, gjë që, siç e përmendëm edhe më lart, nuk rezultoi e provuar.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese çmon se procesi i rinumërimit të votave është kryer në rregull dhe për pasojë shpallja e rezultatit është në përputhje me kriteret e ligjit, prandaj kërkesa duhet të rrefuzohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 131 të Kushtetutës,

nenin 141 të Kodit Zgjedhor, si dhe neneve 26, 66, 67 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M Nr.77, datë 18.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Petrit Plloçi,	Anëtar i “““
Tefta Zaka,	Anëtare e “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalice, në datën 12.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.91 Akti që i përket:

KËRKUESE: DEGA E PARTISE SOCIALISTE MAT, përfaqësuar nga Kryetari i Komitetit Drejtues, Agim Hysa.

SUBJEKTE TË INTERESUAR:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj, me autorizim.

2. HALIL LALAJ, kandidat për deputet i Partisë Socialiste, përfaqësuar me deklaram nga avokatët Ilir Panda e Mirash Martini.

3. GANI HOXHA, kandidat për deputet i pavarur mbështetur nga koalicioni “Bashkimi për Fitore”, në mungesë.

O B J E K T I:

Shpallja e pavlefshmërisë së vendimit nr.968, të datës 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.17 Mat

BAZA LIGJORE:Neni 42 i Kushtetutës dhe neni 141 i Kodit Zgjedhor

Kërkuesi ka parashtruar një seri shkaqesh për shfuqizimin e vendimit të lartpërmendur të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të cilat pasqyrohen me hollësi në kërkesën e tij drejtuar kësaj Gjykate.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Zija Vuci, përfaqësuesin e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Pas përfundimit të zgjedhjeve në datën 24.6.2001 për Kuvendin e Shqipërisë, Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.17 ka shpallur fitues kandidatin për deputet të koalicionit “Bashkimi për Fitore” zotin Gani Hoxha, zgjidhje kjo që është miratuar edhe nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.968, datë 27.6.2001.

Gjykata Kushtetuese, pasi shqyrtoi kërkesën për shfuqizimin e këtij vendimi dhe i dha fund diskutimeve në fazën e bisedimeve në Dhomën e Këshillimit, arriti në përfundimin se dega e Partisë Socialiste Mat nuk legjitimohet në ushtrimin e kësaj kërkesë.

Në bazë të shkronjës “f” të nenit 134 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të partive politike.

Nga përmbajtja e kësaj dispozite del se atë mund ta investojnë për shqyrtimin e këtyre çështjeve vetëm këto parti, por jo edhe degët e tyre nëpër rrethe.

Një konkluzion i tillë gjen mbështetje edhe në formulimin e nenit 2 pika 25 të Kodit Zgjedhor, kur si subjekte zgjedhore janë përcaktuar vetëm partitë politike ose koalicionet e tyre të regjistruara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kandidatët që këto kanë paraqitur ose kandidatët e pavarur.

Meqenëse dega e Partisë Socialiste Mat nuk përfshihet në rrethin e këtyre subjekteve, kërkesa e saj drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në kushtet kur kësaj nuk i janë paraqitur kërkesa nga këto subjekte, duhet rrëzuar për mungesë legjitimiti.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 shkronjat “e dhe f” të Kushtetutës dhe nenit 140 të Kodit Zgjedhor, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

KËRKESË

Kërkuese: Suzana Bodinaku (Pashako) e bija e Ziniut, datëlindja 1963, lindur dhe banuese në Tiranë.

Objekti: Shpalljen të vdekur të vëllait tim Përparim Pashako.

Përparim Pashako, lindur më 11.10.1958 në Tiranë, figuron në regjistrin e gjendjes civile si i gjallë, ndërsa ai është vrarë më 1.4.1990, në kufi në rrethin e Sarandës. Kjo konfirmohet nga shkresa e Prokurorisë së Rrethit të Sarandës e datës 3.3.1994. Meqenëse nuk është kryer asnjë veprim për çregjistrimin e tij nga regjistri i të gjallëve, kërkoj shpalljen e vdekjes së tij.

KËRKUESE
Suzana Bodinaku

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 26.7.2001
Doli nga shtypi më 27.7.2001

Tirazhi: 4100 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2001

Çmimi: 150 lekë